



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 2.2.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Salih Salihu, Velimir Rakiq, Emilije Redzepe, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Murat Hoxha.

Mungoi : Adem Salihaj, anëtar nga PDK ende nuk është emëruar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26.1.2015,
3. Takimi i komisionit me ministrin e MMPH lidhur me planin dhe prioritetet e ministrisë,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime por në pikën e fundit **Murat Hoxha** kërkoi të njoftoi Komisionin rreth qëndrimeve nga Grupi punues për Projektligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Ujrave të Ndotura dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2015

Kryetari i Komisionit pasi që pyeti për vërejtje, z. **Lahi Brahimaj** bëri vërejtje në rradhitjen e gabuar të diskutuesve në procesverbal dhe mospërfshirjen 70% të diskutimeve të tij. Ai kërkoi që plotësimi apo përmirësimi i procesverbalit të bëhet në bazë të inqizimeve të rregullave për transkriptim. Sqarimi i stafit ishte që në mbledhje të komisioneve nuk bëhen inqizimet apo transkript sikurse në seanca plenare, edhe për dëgjime publike apo ndonjë takim i veçantë duhet të kërkohet leje nga Sekretari i Kuvendit për inqizim. Nëse procesverbali nuk përmban ndonjë pjesë nga diskutimi, plotësohet me sugjerim të deputetit dhe kështu kompletohet domethënja e

diskutimit konkret, por jo fjalë për fjalë sikurse në transkript, përfundoi sqarimi nga stafi i komisionit. Z. Brahimaj potencoi se nuk do ti votoj proceset nëse nuk janë në rregull, me çka edhe stafi u pajtua. Procesverbali i fundit me shtesat nga Lahi Brahimaj u plotësua si vijon : **Lahi Brahimaj** pyeti ministrin rreth prodhimit ilegal të farërave, konfliktin e kompetencave Komunë-Ministri rreth menaxhimit të pyjeve, konstatoi se për shkak të gjuetisë ilegale tash në pyjet tona ka vetëm dhelpra dhe ujë, përkrahu moratoriumin dyvjeçar për gjueti të cilin e propozoi ministri.

VËREJTJE NGA STAFI : disa pyetje të parashtruara për ministrin, kanë qenë të ngjashme nga disa anëtar të komisionit, ndaj rradhitja e folësve është ndryshuar pa ndonjë qëllim të caktuar.

Kryetari i Komisionit sugjeroi që pas përmirësimeve të votohet ky proces në mbledhjen e radhës, bashk me procesverbalin nga mbledhja e sotme.

3. Takimi i komisionit me ministrin e MMPH

Kryetari falënderoj për pjesëmarrje ministrin të Mjedisit të cilin e njoftoj shkurtimisht për arsyet pse është ftuar sot në komision dhe i uroj punë të mbarë, ndërkaq ministri **Ferid Agani** gjithashtu falënderoj dhe filloi diskutimin me prioritetet kryesore të kësaj ministrie.

Ai foli për gjendjen e rregullt që e ka gjetë në ministri pas marrjes së detyrës dhe tha se në javët e para ka bërë identifikimin e prioritetëve kryesore të minisitrisë, të cilat janë tri fusha kryesore: mbrojtja mjedisit, planifikimi hapësinor dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore- trashëgimia ortodokse, dhe potencoi se zbatimi i ligjit për ndërtimet pa leje është prioritet i ministrisë për të cilat do të shikohet mundësia e zgjatjes së afatit për paraqitjen e aplikacioneve por në formë të ankesës, nëse paraqiten pas afatit 5 shkurt, ndërkaq pas hartimit të regjistrimit shtetëror të tyre, do të shikohet mundësia e hartimit të ligjit shtesë rreth ndërtimeve në tokat publike, ujitjes dhe komasacionit, si dhe sa i përket licencimit të arkitektëve dhe ndërtimtarëve është gjet zgjidhja dhe këtë javë do të formohet bordi i licencimit të arkitektëve dhe ndërtimtarëve.

Sa i përket fushës së mjedisit (ajri, uji dhe toka) janë marrë me seriozitet vërejtjet e raportit të progresit të Komisionit Evropian ku një nga vërejtjet kryesore është financimi i mbrojtjes së mjedisit. Theksoi taksën ekologjike me vlerë 3 milion Euro në vit, që grumbullohet nga regjistrimi i automjeteve të cilat nuk vijnë në buxhetin e MMPH-së kurse tani kanë përkrahjen e ministrin të financave dhe vetë kryeministrit për këtë. Për mbrojtjen e ajrit, gjatë këtij viti ai tha se do të sjellë ligji aktual me ndryshim dhe plotësim, ndërsa për moszbatimin e “udhëzimit administrativ për emetimin e gazrave nga mjetet mobile” nga ministria e infrastrukturës tha se nuk e ka të qartë pse nuk është aktualizuar, ndërsa tani është caktuar si prioritet.

Lidhur me fushën e ujërave ka legjislacion të bollshëm, vazhdoi, ndërsa “strategjia shtetërore për ujera” do të jetë së shpejti e gatshme dhe do të sjellet në Kuvend. Gjithashtu gjatë këtij viti do të themelohet : Autoriteti i pellgjeve ujore dhe Instituti i ujërave.

Strategjia legjislative e ministrisë për vitin 2015 do të ndryshojë gjatë vitit, ku përveç Projektligjeve për mbrojtjen nga zhurma dhe Projektligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, do të shtohen edhe ndryshim plotësimi i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike, Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Projektligji për banimin, për ndërtimet pa leje. Gjithashtu do të hartohen edhe 44 udhëzime administrative. Për Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma tha se është duke u përgatitë një koncept dhe dokument i ri në të cilin janë përfshi të gjitha debatet e mëhershme për këtë ligj. Fusha e trete është Këshilli për zbatim dhe monitorim i cili do të vazhdojë punën dhe se janë duke zbatuar dy ligjet: për Qendrën historike të Prizrenit dhe atë për Hoqën e madhe, si dhe:

- Puna rreth Prevallës do të vazhdoi me fazën e trete me aktivizimin e task forcës pa asnjë ndasi në mes të qytetarëve (duke respektuar vendimet gjyqësore, përkundër problemeve pronësore që kanë lindur).
- Kroi i Vitakut (në pjesën veriore të Mitrovicës) do të jetë në fokus, deri tani është biseduar me një delegacion të cilët janë ankuar për shkak të lejeve për ndërtim, së shpejti do ti takojë kryetarët e Mitrovicës veriore dhe jugore,

- Ka pasur takim me fshatarët e fshatit Uglare (Graçanicë) rreth problemeve me shpronësimet ku janë prekur nga traseja e autostradës, te cilat janë probleme të natyrshme.

Ministri njoftoi se më 10 shkurt do të ketë takim me 3 ministrat homolog të Republikës së Shqipërisë (pasi që mjedisi dhe planifikimi hapësinor atje është e shpërndarë në 3 ministri) dhe në fund falënderoi duke shprehur gatishtësinë për bashkëpunim.

Lahi Brahimaj fillimisht kritikoi qasjen sikurse që është bërë në këtë mbledhje, që të komunikoi komisioni vetëm 45 minuta me ministrin sepse kjo mënyrë e komunikimit mund të zgjidhej edhe me një imejll, për çka **Kryetari i Komisionit** arsyetoi se kjo qasje ka ndodhur ngase fillimisht ai ka deshtë me anulua takimin për shkak se 40 minuta janë pak, mirëpo pas kontakteve të bëra është dakorduar që fillimisht të mbahet ky takim pasi që tema është e gjerë, ndërkaq në mbledhjet e radhës të bashkëpunoi komisioni më konkretisht për tema të veçanta.

Emilija Redzeqi falënderoi për bashkëpunim dhe u fokusua në rajonin nga vjen ajo (Prevala dhe Mali Sharr) për çka edhe ka zgjedhur këtë komision për angazhim. Ajo kërkoi angazhim të MMPH sidomos për kapacitetet administrative të cilat janë të dobëta, rreth prerjes së pyjeve, Prevala si projekt shumëmilionësh ku është gjendja katastrofale sidomos me kanalizim, pastërti të ajrit dhe bashkëpunim për projekte të ndryshme.

Salih Salihu u pajtua se në këtë mbledhje nuk mund të sqarohen të gjitha çështjet mjedisore, por kërkoi takime të shpeshta ku do të debatohen ndërtimet pa leje në tokat pjellore (për çka ish ministri i bujqësisë ka bërë përgjegjës MMPH/në), bashkëpunimi i ministrive në mes vedi, mbrojtjen e lumenjve dhe lejet/pëlqimet e ndryshme që epen, nafta, mosdhënien e lejeve nëpër komuna (potençoi Vitinë) për çka po pësojnë të gjithë.

Murat Hoxha fillimisht tha se ambienti dhe planifikimi Hapsinorë, përfshi edhe Agjencitë të cilat janë në kuadër të kësaj ministrie, janë fusha më e rëndësishme për Kosovën, në veçanti planifikimi hapësinorë që identifikon dhe parashihet menaxhimin e të gjitha resurseve zhvillimore të Kosovës. Ministria duhet të ketë një plan strategjik zhvillimor nga fusha e ambientit dhe planifikimit, përfshi edhe fushëveprimin e Agjencive, Ai kohën e ndarë nga ministri për këtë takim e vlerësoi se është jashtëzakonisht e shkurtë për ti diskutuar interesimet e Komisionit.

Në vazhdim ai u fokusua në disa çështje si në vijim :

- Sugjeroi të bëhet analiza e Ligjeve dhe akteve nënligjore. Nga fusha e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, në këtë vit janë parapa gjithsejtë 3 ligje të cilat janë shumë të rëndësishme, por të rëndësia duhet të fokusohet edhe në Ligjet nga fushëveprimi i Agjencisë Kadastrale si në, Ligjin për Kadastër, Ligjin për Themelimin e Regjistrat të drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe Ligjin për Hipoteka (në fakt të tre këto Ligje edhe mund të përfshihen në një ligj të vetëm).
- Informacionet kadastrale, janë informacione që mundësojnë realizimin e projekteve të rëndësishme për Kosovën, dhe atë gati në të gjitha fushat e planifikimit dhe veprimit, në radhë të parë zhvillimin e tregut të Tokës dhe zhvillim ekonomik të Kosovës. Këto informacione jo që nuk janë të plota por janë shumë të mangëta edhe për faktin se një pjesë e këtyre të dhënave janë bartë në Serbi. Nga viti 2004 kur është fillua me rindërtimin e të dhënave kadastrale e deri me tani janë përfundua apo janë ende në zbatim rreth 100 zona kadastrale. Kosova i ka gjithsejtë 1302 Zona Kadastrale. Me kete trend nevojiten edhe 120 vjet të përfundon Rindërtimi. Ka pas sugjerime edhe nga ndërkombëtarët që informacionet e tilla të jene interes shtetërore, që do të thotë të ketë afat përfundimi i këtij projekti madhorë për Kosovën, dhe luti ministrin për mendimin e tij për këtë projekt?
- Propozoi themelimin e E-Kadastrit respektivisht Komunikimi elektronik përmes E-sportelit do të ishte strategji e projektuar nga Ministria, e cila tani me sukses aplikohet ne Maqedoni,
- Bashkëpunimi me grupet e interesit respektivisht Shoqatave, do të ishte shumë i rëndësishëm për draftimin e Ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat duhet të reduktohen nga se duhet që ligjet të jene më të detajizuara. Ky bashkëpunim deri më tani nuk ka qenë në nivelin e duhur prandaj edhe shoqatat dhe grupet e interesit kanë vërejtje si në hartimin dhe zbatimin e ligjeve.
- Organizimi Vertikal i institucioneve Kadastrale ishte kërkesë dhe e Komitetit ndërministrorë, por edhe e Shoqatës së Gjeodetëve. Cili është mendimi i juaj lidhur me këtë çështje?

- Mbështetja e Ministrisë në themelimin e Odës së Inxhinierëve dhe Arkitekteve, si dhe e Odës së Gjeodetëve do të jetë strategji pozitive dhe e rëndësishme për këto fusha. Ndërsa ngritja e kapaciteteve profesionale do të jete mundësi e daljes në treg të Profesionistëve, mbase edhe strategji e krijimit të kushteve për ndaljen e Migrimit që aktualisht është duke vazhduar në Kosovë. Si e vlerësoni ju këtë çështje?
- Nga dy Konferencat (njëra prej tyre Regjionale) të organizuara dhe të ndihmuara edhe nga GIZ-i ka dalë kërkesa që Menaxhmenti i ZKK-ve përfshi edhe Drejtoret të jenë specialist të fushës (Kadastra, Gjeodezia dhe administrimi i tokës), a mund të ketë zbatim kjo kërkesë e cila krijon cilësi menaxheriale dhe mundëson realizimin e modeleve të përparuara si ai Maqedon?
- Komisioni ka në planin e veprimit të vetë ta monitorojë zbatimin e së paku një Ligji, a keni ndonjë rekomandim që do të jetë edhe në interes tuajin dhe Ministrisë të bëhet monitorimi i Ligjit për Kadastër?
- Çështja e Impianteve për pastrimin e ujerave te zeza është emergjente për Kosovën. Në bazë të analizave, përfshi edhe ato të konfiguracionit të Kosovës, ka rrezultua që Territori i Kosovës mund të përfshihet në 5 respektivisht 7 impiante trajtimi. Cilat janë planet e Ministrisë lidhur me këtë çështje?
- Lidhur me Autostradat kishte një koment dhe një pyetje. Aktualisht nuk kam vërejte, edhe në informacionet e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit që me plan hapësinorë janë të parapara trasat e Autostradës, e lere ma projektet zbatuese dhe elaboratet e eksproprijimit. Ministria edhe në bazë të informacionit tuaj merret vetëm më eksproprijimin që mbase edhe nuk është e domosdoshme të jetë pjese e juaja me që është pjesë e zbatimit të projektit. Dhe pyeti ministrin, a mendoni se Autostradat duhet të jenë pjesë e planifikimit hapësinorë, pra që kjo Ministri të përcaktojë trasat e infrastrukturës, hartoj planet ideore dhe zbatuese, si dhe elaboratet e eksproprijimit. sepse të gjitha janë fushëveprim i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit.

Haxhi Shala Shtroi 3 pyetje për ministrin: 1. Ligji për qendrën historike të prizrenit, a do të zbatohet në tërësi?; 2. një ndërtesë në oborrin e Lidhjes së Prizrenit, cka do të bëhet me të ? dhe 3. çka parasheh plani hapësinor i Kosovës për Asociacionin e komunave serbe ?

Velimir Rakić u interesua për jetën dhe mjedisin në rajonin e Kopaonikut deri në Vushtrri, sidomos rreth ujit të pijshëm, pasi që analizat kanë treguar se kanë Arsen dhe kërkoi inspektim të vazhdueshëm dhe analiza edhe në këtë rajon nëpër fshatra duke pasur një bashkëpunim më të mirë.

Ferid Agani duke filluar të përgjigjet pyetjeve, fillimisht tha se me këtë rend dite të sotme nuk është e mundur të kemi analiza dhe diskutime të veçanta për problemet e ndryshme mjedisore (fokusi në vërejtjen e Lahi Brahimajt), unë, vazhdoi ai, jam i gatshëm të përgjigjem ftesës së komisionit çdo javë lidhur me sqarime dhe bashkëpunim. Lidhur me kapacitete administrative tha se është pyetje me rëndësi për MMPH dhe kërkohet asistencë ngase ka probleme të resurseve subjektive, ndërkaq për prerje të pyjeve tha se (pasi **Lahi Brahimaj** ndërhyri me pyetjen a ka probleme me Ministrinë e Bujqësisë/Agjencia e pyjeve) janë munduar të zgjedhin problemin me Ministrinë e Bujqësisë duke eliminuar Nenin 7 të Ligjit aktual për Pyje dhe duke jap kompetenca të plota MMPH rreth parqeve nacionale, por e keqja e madhe është se për këtë ligj ka zero asistencë financiare, ka probleme me roje etj. Rreth ruajtjes së tokës pjellore u fokusua në zbatimin e përpikt të Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, sipas së cilës ato ndërtime do të rrënohen, mirëpo mbetet të shihet si do të zbatohet ligji. Vërejtjet rreth hartave zonale dhe çështje kadastrale ai i konsideroi si shtytje për një angazhim më të madhë në Ministri si përgjegje për korigjim dhe organizim të pushtetit vertikal. Sa i përket angazhimeve për impiante ai premtoi realizimin e tyre ngase janë sigurua donacionet për Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Pejë dhe Gjiilan, ndërsa rregullimin e autostradës nga MMPH e siguron edhe Ligji për planifikim hapësinor e cila cakton trasat kryesore. **Murat Hoxha** kërkoi përgjegjësinë e MMPH për hartimin e planeve zonale, kadastrale etj. **Salih Salihu** pyeti për bllokadën në Shterpcë nga organet komunale dhe pagesën për vizitorët, ndërsa ministri tha se menjherë posa ish ministri ka deklaruar në media,

zyrtarët e MMPH kanë dalur të zgjedhin peroblemën dhe ligjëshmërinë e këtij akti, nëse vlerësohet jo ligjore do të hiqet kjo bllokadë. **Lahi Brahimaj** në vazhdim u fokusua në liqenin e Batllavës i cili në krahasim me Radoniqin ka ndërtime të lejuara, dmth pse aty lejohen kurse në Radoniq nuk lejohen. Pasi që ministri u largua nga mbledhja për shkak të obligimeve, sekretari **Arben Çitaku** tha se është fjala për zona të mbrojtura ujore dhe ato janë të kategorizuara, që do të thotë se në zonën rreth liqenit janë të ndaluara ndërtimet, ministria i ka edhe vartësit që kujdesen për menaxhimin e procesit, ku janë kompanit e lejuara ujore, komunat dhe MMPH të cilat kujdesen për ato. P.sh. në Batllavë është ndaluar projekti për plazha, edhe pse janë projekte evropiane. Pasi insistoi prapë z. Brahimaj me pyetje, sekretari z. Çitaku konstatoi se nuk bëhet fjalë për ndalesa por për kritere. Z. **Murat Hoxha** vazhdoi me pyetje rreth ndalimit të parcelimeve nga kadastrin në Prishtinë, pyeti për shkakun, për çka sekretari i MMPH u përgjigj se nuk mund të jap përgjegje complete ngase me këto punë mirët agjencia kadastrale, ndaj mund të ftohet një ditë kryeshefi nga agjencia në fjalë, me rëndësi është që Ligji për ndërtimin definon kriteret dhe parcelizimi duhet të jet strikt sipas planeve komunale. **Haxhi Shala** pyeti për parkun e Sharit dhe bjeshkët e Berishës që përfshin Lipjanin, Drenasin dhe Malishevën dhe memorialet, për çka Arben Çitaku tha se për ato tani kujdeset Agjencia në kuadër të Kuvendit të Kosovës. **Murat Hoxha** u interesua për Odën e gjeodetëve sa kan mbështetje, kurse sekretari tha se me randësi janë liçensimet sipas procedurës, gjë kjo që kërkon kohë, ngase funksionimi duhet të jet ligjor. **Salih Salihu** kërkoi lidhshmërinë e kësaj qeverie (ministrie) me të mëparshmin ngase vetëm në atë mënyrë identifikohen dhe eliminohen mangësitë, përndryshe si të komentohen ikjet e përditshme të popullatës /rinisë dhe humbjet e kapaciteteve humane , e cila është më se e nevojshme Kosovës, për qudi gjithkush nga zyrtarët sillet normalisht dhe nuk shpallet gjendëja e jashtëzakonshme sikurse asgjë nuk po ndodhë. Sekretari u përgjigj se këto gjëra janë parapa në ministri dhe atë në dy drejtime, të kapaciteteve humane dhe politike dhe janë orijentua zgjidhjet konkrete si p.sh. në lumenjt ku nuk do të lëshohen asnjë leje etj. **Salih Salihu** çka për shembull.

Arben Çitaku 1. Transferi i kompetencave me ligjin për parqe nacionale nuk kemi trashëgu dhe nuk ka reflektuar, nuk janë bart mjetet dhe nuk ka mundësi ligjore rreth rojeve të pyjeve 2. Çështja e buxhetit ku 95% shkojnë në shpronësime, vetëm 6.5% për investime kapitale, për fat të mirë ka donator 3. Për UA (udhëzime administrative) në fuqi nuk ka vullnet për zbatim. **Illir Morina** (kryeshef i agjencisë për mjedis) gjithashtu ceku tri probleme që pengojnë zbatimin, ngase 60 % të zbatimeve bëjnë 1. Komunat 2. Drejtësia (mos zgjidhja e lëndëve nga gjykatat), Agjencia e pyjeve e cila nuk kryen punën, dmth kemi pengesa ligjore, 3. Energjia duhet të rregullohet në ministrinë e energjisë e jo në MMPH. **Arben Çitaku** shtoi se p.sh. MMPH nuk mund të veproji kundër gurthyesve nëse ai e plotëson kriterin bazik që do të thotë se Komisioni për minerale së pari duhet të caktoj zonat , pastaj të veproji MMPH. **Salih Salihu** vazhdoi, nëse është ashtu rreth shfrytëzimit të energjisë, pse atëherë nuk meren puntorë për të pastruar rremat gjatë prerjes së lisave, ngase fidanet mbulohen nga mbeturinat dhe nuk dalin, a nuk ka kush të mendoi për këto gjëra, përfundoi. Diskutimi vazhdoi rreth mundësive të ndryshme duke mar shembuj të ndryshëm sekretari i MMPH dhe **Ilir Morina**. **Emilija Redzeqi** kërkoi mbrojtjen e bashkësisë etnike të Sharit duke falënderuar për sugjerime dhe ndihmat nga ministria, dhe shtoi se në zonën e mbrojtur të Prevallës ka pasur shumë keqpërdorime madje edhe krim të organizuar, ndaj më tepër duhen inspektime në terren, për pyje sidomos, kujdesi ndaj OJQ lokale të cilat do të janë implementues financiar, uji në ZHUP nuk është në rrjetin e ujësjellësit dhe kjo të arrihet me mjete politike por jo me dhunë, pra Zhupa të funksionoj si territor, projekti milionësh i Prevallës duhet të kryhet për shkak të tërheqjes së investitorëve (të rregullohen kanalizimet etj) dhe të përmirësohet jeta e banorëve. **Lahi Brahimaj** shtoi se parku nacional në Deçan është në gjendëje shqetësuese, askush nuk kryen punën e vet. **Arben Çitaku** lidhur me Zhupën dhe ujin tha se ujësjellësi është paraparë por nuk garanton qëndrueshmëri, ky rajon duhet të pranoi autoritetin e hidroregjionit dhe kodin subvencionues.

4. Të ndryshme

Murat Hoxha njoftoi komisionin lidhur me dy kërkesat e GP. Në takimin e fundit të Grupit të punës lidhur me Ligjin për Ujësjiellës dhe Kanalizim, tregoi se është diskutuar për mënyrën e qasjes së trajtimit në mënyrë që ky ligj të jetë sa më cilësorë dhe i zbatueshëm. Në këtë kontekst janë marrë sqarime edhe nga Drejtori i ZRRUK z. Raif Preteni dhe z. Baton Begolli Këshilltarë për ujëra në Kryeministri. Grupi punës paraqiti një numër vërejtjesh në disa Nene, të cilat ishin edhe objekt debati në grup. Diskutimet reflektuan dy propozime të rëndësishme të cilat po iu paraqesim tani Komisionit për miratim.

1. Grupi punës pas diskutimeve, identifikoi nevojën që të fillojnë procedurat për emërimin e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues, në kuadër të Zyrës së Rregullatorit të Ujësjiellës dhe Kanalizimit. Në takimin e dytë të Komisionit është diskutua kjo çështje dhe parimisht jemi akordua që kjo procedurë apo ky emërim të bëhet pas miratimit të Ligjit të ri për Ujësjiellës dhe Kanalizim. Gjatë diskutimit dhe analizimit të kësaj çështje në Grupin e Punës, u vlerësua se procedurat deri te miratimi i Ligjit kërkojnë mjaft kohë, madje mund të vazhdojnë deri në gjysmën e dytë të këtij viti, duke marrë parasysh që pas hartimit të draftit final, ligji do të duhet ti epet në shqyrtim edhe Ministrisë, e cila ka afat 1 muaj për kthim në Komision respektivisht në Shqyrtimin e parë dhe të dytë në Parlament. Ky vlerësim nxori iniciativën që sa më parë të fillojnë procedurat, duke u bazuar edhe në Ligjin Aktual, ndryshimi i të cilit nuk ka ndikime esenciale në këtë Emërim. Emërimi i kryesuesit është shumë i nevojshëm madje i domosdoshëm nga se mund të ketë vonesa në shqyrtimin e ankesave eventuale, duke krijuar pamundësi të zbatimit edhe të procedurave ankimore sipas Ligjeve përkatëse dhe mund të ketë edhe pasoja buxhetore. Komisioni në Konsultim edhe me Drejtorin e ZRRUK-së, rekomandon që për shkak të vëllimit (të supozuar) jo të madh të lëndëve ankimore, Kryesuesit ti përcaktohet një pagë fikse mujore e cila përveç se do të jetë motiv kryerjen e përgjegjësisë të parapara me Ligje, të ketë mundësi angazhimi tjetër primarë apo sekondarë, duke qenë i kufizuar në punët të cilat do të kualifikoheshin si konflikt interesi. Prandaj edhe një herë ju ftoj që në emër të grupit të aprovonit këtë propozim në manire që nga sekretaria të përcaktohen kriteret ligjore për zbatim të këtij propozimi.
2. Bazuar në rëndësinë e hartimit të Ligjit për Ujësjiellës dhe Kanalizim, vërejtjet fillestare nga natarët e Grupit, sqarimet nga Drejtori i ZRRUK-së z. Raif Preteni dhe Këshilltarit z. Baton Begolli, mundësisë që ky Ligje edhe ashtu të merr kohë relativisht të gjatë të procedurave të hartimit deri të shqyrtimi dhe miratimi në Kuvendë, Grupi propozon që lidhur me këtë Ligj të angazhohen edhe dy ekspert, një nga fusha Juridike dhe tjetri nga fusha teknike – profesionale për Ujësjiellës dhe Kanalizim. Mendoj se ne si grup por edhe Komisioni do të duhet të ketë një siguri për cilësinë e Ligjit dhe zbatueshmërinë e tij. Besojë se do të gjenden mundësi për mbulimin e shpenzimeve të cilat supozoj se nuk do të ishin të mëdha.

Salih Salihu u fokusua për mënyrën e pagesës së kryesuesit dhe çështjen se ku mundet ai të angazhohet shtesë. Komisioni nxori këtë :

REKOMANDIM

1. **AUTORIZOHET Kryetari i Komisionit të bisedoi me Sekretarin e Kuvendit rreth çështjes së modalitetit dhe kriterëve të konkursit për kryesuesin e komisionit shqyrtues, pastaj të kthehet çështja në komision ku vendoset për shpalljen e konkursit.**
2. **Në mbledhjen e radhës komisioni të hartoi listën e ekspertëve për ligjin sipas radhës dhe ato vijuese.**

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka

NJOFTIM SHITESË : Pas mbledhjes Kryetari i Komisionit diskutoi me Sekretarin e Kuvendit me të cilin u dakordua që të përcjellët çështja në Grupin punues ku do të shqyrtohen kushtet dhe modalitetet e konkursit. U kërkua që në grupin punues të diskutohen mënyra e pagesës (u propozua pagesa 100 euro për një ankesë, pas çdo raportimi), kush paguan, mandatin.